



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Komuna e Vitisë
Opstina Vitina
Municipality of Viti/na

PROCESVERBAL

I MBLEDHJES SË TRETË TË RREGULLT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË VITISË

Mbledhjen e ftoi dhe e kryesoi z.Naim Pira, kryesues i Kuvendit të Komunës së Vitisë.

Mbledhja është mbajtur më 28.03.2019 (e Enjte) në Shtëpinë e Kulturës “Gursel dhe Bajram Sylejmani”, duke filluar me punë në ora 10 h.

Në mbledhje morën pjesë: kryesuesi i Kuvendit, z.Naim Pira, kryetari, z.Sokol Haliti, nënkryetari i Komunës, z.Hasan Aliu, si dhe këshilltarët e Kuvendit: Basri Sylejmani, Valbona Haziri, Afrim Ramushi, Ali Bajrami, Xhilsime Qamili, Nuredin Lutfiu, Zekirja Zuka, Nijazi Isaku, Jakup Demiri, Sejdi Emini, Remzi Salihu, Mirlinda Sadiku, Liridona Bislimi, Bekim Azizi, Taulant Haxhiu, Blerina Lubishtani, Samet Idrizi, Idajete Pira, Avdi Rexhepi, Ekrem Abazi, Vehbi Rama, Valentina Hasani, Rasim Terziqi, Besim Ymeri, ndërsa munguan Vjollca Kadolli-Halili, Rufadije Halimi-Rexhepi. Në mbledhje morën pjesë edhe drejtorët e drejtorive, përfaqësuesi i OSBE-së, KDI-së mjetet elektronike.

Pasi u konstatua se prezent janë 25 anëtarë të KK-së, kryesuesi i Kuvendit e shpalli të hapur mbledhjen.

Kryesuesi z.Naim Pira: Mirëdita dhe mirë se keni ardhur në seancën e tretë të rregullt të Kuvendit Komunal të Vitisë! Më lejoni të përshëndes, nënkryetarin e Komunës, juve të respektuar këshilltar komunal, drejtorë të drejtorive të cilët janë prezent në këtë seancë, përfaqësuesit e OSBE-së, KDI-së mediat elektronike dhe të gjithë të tjerët që janë prezent. Para se të kalojmë te miratimi i rendit të ditës, nëse ka dikush të parashtrij pyetje ose propozime, fjala është për ju, urdhëroni. MAPL-ja naj ka konfirmu ligjshmërinë e disa nga aktet e miratuara ne seancën e fundit. Në mbledhjen e fundit të KPF-së Jakup Demiri ka pas një kërkesë rreth njësorëve të KEDS-it. Ka marr obligim që nënkryetari të punoj me njerëz kompetent dhe sot jav ka sjell këtë informatë në kuvend dhe do t'i shikojmë hapat që do t'i ndërmarrim ne vazhdim. Tani kaloj te pyetjet dhe përgjigjet jashtë rendit të ditës.

z.Jakup Demiri: Përshëndetje të nderuar të pranishëm. Na ka ardh një material, ne u dakorduam që materiali që e merr prej KEDS-it me ardh, po jo mos me figuru pika në rend dite, sepse tash pjesa dërmuese e asamblistëve nuk din se çka me fol, sepse nuk kanë informatë. Këtë vërejtje e pata.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Fillimisht e falënderoj këshilltarin që e ka ngrit një çështje që i shqetëson qytetaret e Komunës së Vitisë, megjithatë në KPF jam zotu që do të interesohem për këtë punë dhe po atë ditë kam thirr shefin e njësitit në Viti, Liridonin dhe kam bisedu për këtë punë të Hënën. Më ka njoftu që nuk po e lejon drejtoria në Prishtinë, që pa e bë një kërkesë me shkrim ne nuk mujm me ju pru informata dhe unë menjëherë të Hënën i kam dërgu kërkesën me shkrim, ja ku e kam të protokolume kërkesën. Ata e kane sjell këtë informatë, në rast se ju mendoni që këtë informatë mundem ta shtjellojmë në mbledhjen e ardhshme. Materialin sot e keni marr me kohë, kisha kërku prej juve ti leni e-mail adresat, se kam edhe material shumë me të gjerë se kjo, që ju kemi sjell, dhe çdo këshilltari komunal ju kisha dërgu në email adresën, i kisha thanë asistentit tim, që të ja dërgon që edhe ju ta keni informacionin e plotë dhe debatojmë në seancën e muajit

Prill. Kjo vërejtje prej juve, qyshe ju e shihni të rrugës, asnjë fjali unë nuk e kam shti këtu, i sheni kush e ka bë këtë informatë.

znj.Mirlinda Sadiku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Po e ngris për disa herë këtë shqetësim me nr. të protokollit 196, me datën 08.06.2016. Kërkesë nga ish drejtori Feti Sahiti, që qeta mësimdhënës nuk janë pagu për punën që e kane kry. Qekjo shkollë, hiq me pak se 20 mijë euro ka gjeneru të hyra për komunën, prandaj nuk është e drejt, këtu janë nënshkrimet e profesorëve që e kanë mbajtur mësimin dhe pajtohen me ata që nuk janë pagu për punën që e kane kry. Për herë të fundit po kërkojnë, përndryshe tash e tutje do të drejtohem edhe me shkresa zyrtarisht, sepse bazë përgjigjes që e ka dhënë drejtoresha në seancën e janarit nëse nuk gaboj, keni thënë do të shikohen mundësitë ligjore dhe financiare. Është e padrejtë ndaj qetyre profesorëve që këta mos mu pagu për punën që e kanë bë. Kjo është afati i qershorit 2014, d.m.th fillimi i qeverisjes se juaj. Një çështje tjetër që e kisha ngrit është, sinqerisht jam ndje shumë keq për Flakadakun e Karadakut, kur kemi shku me bë homazhe, çfarë gjendje është vendi aty i varrezave, d.m.th përgjegjësia bien mbi institucionet komunale, për arsye se kot mundem me qu lule me ju bë nderime dhe homazhe, kur përgjegjësia institucionale bien mbi juve që duhet të rregullohet ai kompleks. Ata njerëz e kanë dhënë jetën e nuk kushton kurgja prej buxhetit me nda një buxhet të dinjitetshëm e kanë ngrit kolegu Avdiu ne seancat e kaluara, po si duket hasi në vesh të shurdhër. Një çështje tjetër e kërkojnë sqarim. Muj me qenë gabim, prej 205 vendimeve që i kam kontrollu në web faqen zyrtare, edhe në arkiv, nuk kam mujt me e gjetë që shtëpia e cila gjendet në Stubell të Poshtme të therralit, që është pronë e Ekrem Abazit, me sa kam bisedu me këtë, me ka than që ekziston një vendim që ajo shkollë është në mbrojtje të komunës, për arsye se dikush mundet me ditë, dikush mos me ditë, ajo shtëpi aty janë shëru personat e plagosur gjatë luftës. Nëse ka vendim, pse nuk është mbrojtje institucionale, po nëse nuk ka unë propozoj që kjo shtëpi të jete për brezat me tutje dhe të hynë në mbrojtje institucionale, njëjtë sikur shkolla e par shqipe.

z.Nijazi Isaku: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Unë po ndërlihem me propozimin që u diskutu në mbledhje. Meqenëse ne e kemi informatën, po për hirë të asamblistëve të tjerë që nuk e kanë materialin, atëherë dakordohemi, që kjo pikë për KEDS-in të vjen në mbledhjen e radhës dhe të diskutojmë, besoj që nuk bëjmë veprim që është i kundërligjshëm, po ne jemi konsultu edhe me ligjet dhe kemi mendu që KEDS-si është duke bë shkelje ligjore që i vendos ato njësor aq lartë. Me ligj e ki, deri 1.5 metra është minimumi po jot tash me qu 2 ose 3 metra. Kjo praktikë ka ndodh edhe në disa komuna. VV e ka inici, po për hir të asamblistëve e diskutojmë në mbledhjen e radhës.

z.Zekirja Zuka: Përshëndetje për të gjithë. Jemi dëshmitar të përditshëm, se ne mese dit tek stacioni i autobusëve, sidomos nga ora 12:00 deri 13:00 bëhet rrëmuj dhe thuaja se bllokohet i gjithë komunikacioni, bëhet kolona ne dy shirita nga stacioni deri të xhamia, e në anën tjetër deri të viva fresh. Kështu që po rrezikohen më se shumti këmbësorët e sidomos nxënësit, po po pengohen edhe automjetet, kur dijet që se shpejti do të dalin edhe zjarrfikësit në atë hapësirë dhe mos thaftë zoti që në atë kohë të ndodh ndonjë zjarr, se përndryshe ata nuk do të mund të dalin nga shtëpia e tyre, mirëpo unë kam një propozim, ma merr mendja që do të bëjë zgjidhje dhe do ta lehtësoj kalimin pa pengesa, sepse nënkalmi ekziston nga parku “Hasan Alija”, i cili ka edhe tretuar, ka po ashtu edhe shkallët brenda të cilat lidhen me trotuarin e “Moravës” dhe lidhet me memorialin e Rashti Mustafes, i cili gjithashtu ka edhe shkallë të mjaftuara edhe tretuar. Krejt çka na nevojitet aty, është barrierat rreth lumit. Kështu që drejtoresha e Arsimit duhet të bisedoj me drejtorët e shkollave e ata me nxënësit e tyre dhe besoj që ky problem do të zgjidhet dhe do të shpëtoj edhe nxënësit nga ndonjë e keqe dhe do të lirohet rruga për automjete.

z.Basri Sylejmani: Përshëndetje për të gjithë! Unë kisha një dy çështje. Fusha e sportit në Sadovinë, nesër behet përurimi i fushës në ora 13:30. Ju ftoj juve asamblistëve dhe gjithë dashamirët e sportit, të cilët janë për me marr pjesë. Ajo fushë është në emër të Pozharanit që e kemi fitu at donacion, dhe e kame një apel për qytetarët e Vitisë, se çdo ditë dal e vizitoj rrugën e Letnicess, Sadovines, Binques, i shof shportat të gjitha janë të rrezuara ose i kane

marr. Unë i apeloj të gjitha institucionet e Vitisë pa marr parasysh parti, t'i tregoj njerëzve që kjo është para e popullit e duhet ta ruajmë.

z.Taulant Haxhiu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Unë sot kam një propozim, të cilën ma kanë kërkuar sektori privat, pasi edhe unë jam afarist i kësaj komune, dje dhe pardje kam biseduar me gjithë hipermarketet e mëdha të Komunës së Vitisë, se gjithë sektorin privat e kam një propozim për kryetarin e komunës z.Sokol Halitin, Kuvendi Komunal dhe Drejtorin e Inspeksionit, që dita e Diell të jetë ditë pushimi për sektorin private. Ditën e Diell të punojnë vetëm kafiterit, restorantet dhe automekaniket. Pse automekanikët, për shkak se shumica jemi në punë dhe dita e Diell është me e favorshme ti rregullojmë makinat, po është e mire që edhe maketet të koordinohen në mes veti, të punon një market me rotacion, çdo muaj të punon një market qyshe të koordinohen ata. Unë kërkoj nga ju, që deri në Maj të fillon kjo dhe të implementohet kjo si propozim i imi. Pyetjet tjetër e kame për drejtoreshën e Arsimit. E kame marr një informatë nga banoret e Pozharanit, që një profesoresh prej fshatit Bibaj të Komunës së Ferizajt, e gjuhës frënge, ka ardh në zëvendësim në Pozharan. Pak na kemi profesoresha që me ardh në zëvendësim, po keni shku e keni marr për shkak se është balldeska e kryetarit Sokol Haliti, e keni marr vajzën e kirurgut Skender Shabani me be zëvendësim. Drejtoresh, Vitia ka kuadra që e dinë gjuhën frënge dhe duhet të jenë nga Komuna e Vitisë. Dhe një pyetje, unë e shoh që kryetari i komunës ja ka dhënë televizionit “Iliria” me e transmetu llajf, asnjëherë Tv “Iliria” nuk e transmeton live. Ne si asamblist i kësaj komune, na duhet të kemi transmetimin live, le ta shohin qytetarët e Vitisë performancën tonë. Tv “Plusi” është televizion me efikas, pse mos të jet Tv “Plusi” këtu që ta transmeton live. Po e marr një televizion i cili ka lidhje me qeverinë e Sokol Haliti, ja jep kontratën që mos ta shohin qytetarët live. Ju lutem, kërkoj që ky televizion ta bënë transmetimin live.

z.Ali Bajrami: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kam një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, konkretisht për shkollën fillore “Dëshmorët e Vitisë”, paralelja e ndarë në Drobesh. E dimë të gjithë çfarë gjendje është ajo shkollë. Takimet kanë qenë të pa rreshtura. Në takimin e fundit, kërkoj nga drejtoresha të na jep një shpjegim, çka është bënë në këtë drejtim sa i përket kësaj shkolle.

z.Nijzazi Isaku: Faleminderit kryesues, përshëndetje të nderuar të pranishëm! Edhe unë pajtohem me at që e tha Taulani, për ingjizimin e seancave. Unë e kam ngrit edhe në mbledhjet e kaluara, është udhëzimi administrativ, besoj që e kam shpjegu mbledhjen e kaluar që është tu bë shkelje. Kjo, nëse e marrmi seancën e kaluar, nuk mundesh me gjetë kërkun, e kam fjalën për seancën e jashtëzakonshme. Sun e gjen kerkun, dhe këta e kanë obligim, për detyrë me dal drejtpërdrejt në youtube. Ju e keni bënë në televizion, ndoshta u kanë e mirë me ju dhënë pak subvencione televizioneve, por detyra e këtyre është me transmetu kuvendin komunal drejtpërdrejt në publik, që me pas qasje edhe masanej që me pa asamblisti. Vitin e kaluar nuk kemi pas 6 muaj ditë mjete të informimit, a është bënë qëllimisht kjo nuk e di, me plan të prokurimi ka qenë në fillim të vitit.

z.Remzi Salihu: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Kame dy çështje. Njëra i përket shkollës së vjetër në Letnicë dhe tjetra i përket trotuarit në rrugën Viti-Pozharan. Nuk e di sa jeni të informuar, apo drejtoresha e Arsimit a e ka vizitu ndonjëherë shkolle fillore në Letnicë, paralelen e ndarë në Stubëll dhe deri ku ka arrit çështja e ndërtesës së vjetër të shkollës, e cila është pranë shkollës së re. Aty është një objekt i rrenuar gati plotësisht, po i cili është shumë i rrezikshëm për fëmij. Këtë po e thamë se e kame vizitu vet me kolegët të VV-së dhe e kam pa se çfarë rreziku është aty dhe nëse drejtoresha ka marr ndonjë kërkesë, sepse neve na është thënë që kanë bënë kërkesë të rrenohet ai objekt dhe kanë bënë kërkesë për rrethimin e oborrit, sepse në oborr aty kishe çmos, kishe kamjana, traktora privat edhe kafshë po depërtojshin aty pari sa herë që kanë rastin. Çështja e dytë është trotuari në rrugën Viti-Pozharan, është një trotuar saktësisht 6.98 metra. Nuk e di unë ai tretuar, ajo pjesë ish mjaft e frekuentume nga fëmijët që vinë në shkollë edhe në shkollën fillore dhe at të mesme. Një pjesë, ish trotuari po me një pjesë nuk ish, nuk e di a është në plan projekt për ta rregulluar këtë trotuar, po nëse e krahasojmë me trotuarin që është ndërtuar prej Gernove në Sadovinë, të cilin rrallë kush e frekuenton atë trotuar, mu ma merr mendja ky ka qenë me prioritet.

z.Sejdi Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Sot do ta ngris një shqetësim që nuk është vetëm i imi, po edhe i banorëve. Kemi ngrit edhe ju si asamblist, punët jocijësove që po kryhen në territorin e komunës. Sonte kemi pas rastin, ku një rrugë në fshatin Goshicë tash se fundi është bërë gati për mu asfaltu, mirëpo qaq keq është bërë puna sa që kompania e ka prurë edhe asfaltin për me e shtrur, mirëpo banorët kanë qenë shumë të pakënaqur, sepse aty ka qenë baltë edhe janë detyruar me i qit makinat në rrugë dhe me i kthyer mbrapa kamjanat me asfalt. Unë kisha bërë thirrje edhe juve si qeveri, e sidomos atyre mbikëqyrëseve të cilët marrin pagë për këtë punë, të dalin në teren dhe punët t'i monitorojnë me kujdes shumë të madh, sepse nëse vëmë kësi pozita, që qytetarët dalin dhe e ndalin rrugën, sepse ata e kanë kuptuar që ajo para është taks e tyre, ata nuk lejojnë ma shkel e shko mos me ju qit në pozitë të keqe as juve as qytetarët. Këta zotnit që paguhet për atë punë, është mirë me marrë përgjegjësi të plotë dhe mos me lan me ardh në këtë gjendje që kemi ardhur në Goshicë.

z.Ekrem Abazi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit! Atë që e pata të njëjtën me thanë e tha parafolësi, po e shtoj edhe një sen, kryetari para nja dy tre muajve me një debat tha, që do të dënohen të gjitha firmat që nuk e kanë krye punën me nderë në bazë të ligjit që janë kanë me krye. Po ju pyes, a ka ndonjë firmë që është dënuar që mos me ju bërë pagesa, a ka ndodhur që nuk ju ka bërë pagesa dhe a ka ndonjë mbikëqyrës që është dënuar për punët e këqija që janë tu bërë. E dini krejt ju siç e dimë edhe na, nuk e di apo ju vjen marre bre se asnjë punë nuk kryhet me nder. Rrugën ka na po e përmendi i kanë qit 20 kamjana dhe si ka ra shihu u pa u bërë krejt lloq. Rruga të asfaltuara, mas dy dite, krejt kur ta këshyrë u prish asfalti. Unë po dyshoj që punëkryesi dhe mbikëqyrësat bashkë me udhëheqësin komunal kanë marrëveshje me përfitu për veti. Është dyshim i imi, këtë dyshim e kam sidomos vitet e fundit. U bërë 20 vite në dy lagje në Viti, nuk ka kanalizim lagjja te pumpa e Alidemëve, vetëm me shku me e këshyrë tash sun rrinë prej erërave dhe të viva aty nuk ka kanalizim. Ka kanalizim në fshatra që ndoshta nuk ka pas nevojë hiq e nuk ka aty ku duhet me pas kanalizim.

znj.Liridona Bislimi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Më intereson çështja e bursave, deri ku ka mbetur kjo punë. Dijet që konkurs është hapur me 02.10.2018, pra kanë kaluar 5 muaj dhe ende nuk kemi ndonjë vendim sa i përket kësaj teme. Gjithashtu kam marrë informacione nga 5 studentët e Komunës së Vitisë, të cilët i takojnë familjes së dëshmorëve, dy prej këtyre kanë qenë në universitete private, ndërsa 3 prej tyre në universitetet publike dhe nuk kishin fituar bursë. Me sa e di unë, kriter për të fituar bursë i takon edhe atyre të familjes së dëshmorëve, normalisht edhe me nota të mira. Gjithëashtu transporti i nxënësve në fshatin Debulde ka qenë premtim, e dimë të gjithë që ka premtuar kryetari. Tash po përfundon gjysmëvjetori, ka thanë që do të bëhet vazhdimisht, mirëpo nuk është bërë edhe çka me la përshtypje nga Ali Bajrami, i cili e ceku shkollën në Drobesh, e unë dhe kolegja ime Valentina e kemi përmendur vazhdimisht se çka ka luajtur puna për këtë shkollë, se asnjëherë nuk kemi marrë përgjigje, ndërsa tash po del një asamblist i një fshati tjetër dhe po pyet, po kërkon përgjigje. Ta shoh se çka paska ndodhur që ne nuk po dimë.

z.Jakup Demiri: Kam një pyetje, a ka ndonjë ankesë kontrata për punimet shtesë në kanalizimet e Smirës në këto tre muajt. Nëse nuk ke përgjigje mundesh me naj sjell, sepse po duhet me ditë si fshat ne, sepse po na duhet këshillit të fshatit.

znj.Xhilsime Qamili: Unë kam një pyetje për drejtoreshën e Arsimit, pasi që shkollat e tona ballafaqohen me mungesë të psikologeve, atëherë pyes drejtoreshën, a është ka ndërmerret ndonjë veprim nga kjo drejtori përkatëse, pasi që veprimtaria e tillë e arsimit është shumë e arsyeshme për qytetarët dhe për shkollat tona.

Drejtoresha znj.Fatbardha Emini: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Pat disa pyetje, Mirlinda e përsëriti pyetjen e çështjes se pagesave të mësimit jo formal. Unë kam kompetencë të flas edhe për atë prej mandatit që e kam marrë, d.m.th janë pagu të gjitha afatet e provimeve dhe mësimeve jo formal, ndërsa është një borxh i vitit 2014, të cilin e kam shiku edhe në aspektin administrativ, që nuk është borxh i bartur. Do të shohim mundësitë e tjera ligjore, se si është mundësia me bërë pagesën e këtij angazhimit të mësimeve, asnjëherë nuk kam thënë që një punë që kryhet, nuk duhet mu shpërbly për vetëm me i shiku mundësitë ligjore se si janë, për shkak se nuk figuron

si borxh i trashëguar kjo pagës e mësimit jo formal. Taulanti e ngriti një çështje që konsideroj që vetëm sa me thanë diçka, për shkak se përzgjedhja e mësimeve behet me konkurs publik edhe kane të drejt të konkurrojnë të gjithë qytetarët e Kosovës. Ju e potencuat për lënden e gjuhës frënge. Nuk është e vërtet që ka pas kandidat nga Vitia. Kemi pas tre kandidat, dy nga Gjilani dhe një nga Ferizaj dhe komisioni ka vlerësua poentimin e kandidatës nga Ferizaj. Ali Bajrami e ngriti një çështje, është e vërtet që Komuna e Vitisë ka kërku tek komisioni parlamentar, me që mundësitë buxhetore dijet se si janë edhe nuk kemi pas projekcion nga ana e ministrive të linjës për shkollën fillore në Drobesh, andaj tu e shfrytëzu këtë rast, komisionin parlamentar për buxhet dhe financa, kryetari i komunës, bashkërisht i kemi propozu një amendament edhe shkolla e Drobeshit tani e keni pa është ne projekcion të viti 2019 bazë amendamentit buxhetore. Kështu që, dje kemi qenë në takim në ministri dhe pritët shumë shpejt me fillu punimi i ndërtimit i shkollës në Drobesh. Sa i përket shkollës në Letnicë, kemi bë kërkesë që me e largu nga asetet për shkak se duhet të ketë procedura për me e rrenu një shkollë siç kemi vepru me shkollën e Sllatinës i kemi zhvillu të gjitha procedurat edhe për shkollën e Letnices. Jemi në procedura e sipërme, çështja e bursave, komisioni tani është në përfundim e sipër, disa spekulime që nuk i takojnë një këshilltare jo ajo jo ky unë nuk e di që ka dal ndonjë listë se kush është përfituese absolut, as komisioni ende nuk e dinë, sepse është duke punuar dhe është keq me fol fjalë që nuk janë zyrtare. U ceken çështja e psikologeve, edhe psikologët kane kaluar në amendament buxhetor, kështu që jemi në fazën e lejimit të Ministrisë se Administratës Publik që me e hap konkurs. Besoj shume që sivjet i kemi prioritet.

Enkryetari z.Hasan Aliu: Përshëndetje edhe për kryetarin e komunës, këshilltar të kuvendit! I falënderoj për të gjitha ato shqetësime që i drejtuar. Unë do të bëjë përpjekje të ju përgjigjem. Çështja e varrezave të dëshmorëve, ne nuk e kemi ni veten keq në pamundësi që me bë më shumë, por po të tregoj që në këtë drejtim kemi bë hapa pozitiv dhe është një projekt që do të realizohet brenda këtij viti dhe do të rregullohen edhe ato pjesë që janë të pa rregulluara. Vlera e projektit e kalon shifrën mbi 50 mijë euro dhe konsideroj që do të jete e mjaftuar për atë që e meritojnë që me i rregullu. Shtëpia në Stubell me sa e di me planin zhvillimore komunal është e futur si shtëpi që meriton mbrojtje dhe besoj që jo vetëm ajo shtëpi, po janë shumë shtëpi që ndoshta në pamundësi që me bë me shumë po megjithatë ende nuk është një fond i tillë që do ti mirëmban. Zeka e pat një kërkesë, që mendoj është me vend, besoj që do ta kemi parasysh. Basria e ngriti një çështje edhe ne konsiderojmë që atë që e propozon Basria është me vend që ti ruajmë investimet. Ishte një propozim me vend i Taulantit, i cili e informoj që e kam të shënuar në fletore, që ne mbledhjen e mbajtur të bordit të drejtorëve me kryetarin e komunës, e i cili ju ka propozu shumë drejtorive propozim rregullore e një prej të parave ka qenë, edhe rregullorja mbi orarin e punës se shpejti e përgatisim dhe do ta sjellim në kuvend çështja se kur të hinë ne fuqi janë aspekte procedurale. Çështja e trotuarit, jemi duke punuar në atë drejtim, po pa mundësi buxhetore, po naj le disa shkurtesa, po megjithatë kemi avancu bukur shumë, e besoj edhe kjo që e ngrite ti si çështje do të kryhet. Për punë jo kualitative, jo cilësore, unë besoj që aty ka pas njerëz edhe të institucioneve, të cilët nuk janë pajtu me atë dhe çështja e ngritjes së cilësisë, jemi tu bë përpjekje të vazhdueshme që me e ngrit. Do ta shohim në të ardhmen se sa do ta ngrismi cilësinë, edhe një prej brengave që e kemi edhe ne, ke pyetje a është dënu ndonjë firmë për cilësinë e dobët, po kemi plot firma që nuk ju kemi leshu mjete në mesin e tyre edhe ajo me kanalizimin në Smirë që nuk ju kemi pagu pjesën e fundit, për shkak punëve të pakryera dhe jo kualitative. Po punojmë edhe çështjen e kanalizimit edhe të Alidemt dhe të Viva, që një ditë edhe ata qytetar ta keni kanalizimi. Çështja e Debelldehut për bartjen e nxënësve, është pengesë ligjore. Më doket jemi përgjigj shumëherë, aspekti ligjor nuk e lejon bartjen e nxënësve të shkollave që konsideron shkollës së mesme. E pyet, a ka ndonjë aneksë kontratë për kanalizimin e fshatrave Smirë, konsideroj që nuk ka.

znj.Mirlinda Sadiku: Po e marr të drejtën të flas edhe në emër te Liridones. 5 muaj mu vonu, bursat për çka për 300 euro. Kjo është papërgjegjësi totale. U cek pagesa e mësimit jo formal, që ku i kemi kërkesat që ju kanë drejtu e ju tash thuani që nuk keni trashëgu borxhe. Nëse ndërrohet drejtorët, përgjegjësia institucionale mbetet dikush, duhet me e marr përgjegjësinë. Është e padrejtë ndaj këtyre profesorëve mu bë kështu dhe me vepru kështu.

20 mijë euro ti ka gjeneru të hyra për 4 vjet komunës, e qato pare ku janë, ka kanë shku, kush i ka marr. Kam një provoj të hidhur edhe në kohe kur ka qeverisë Musa Misini, prandaj kjo nuk është spekulim. Krej çka na intereson është me ditë a do të paguhen, këtë vit keni me i pagu apo nuk keni me i pagu. Sa i përket planit zhvillimore komunal, nëse është parapa ne atë plan i cili nëse nuk gaboj është miratu ne vitin 2010. Kjo e ka obligu që edhe at shpi me e shti në menaxhim, d.m.th për 5 vite të qeverisë. Nuk muj me gjet buxhet që me e funksionalizua dhe të ja lam trashëgimi gjeneratave të reja që do të vinë.

z.Taulant Haxhiu: Drejtoreshë, unë për profesoreshën që e keni marr zëvendësim, unë para se me ardh në seancë, një profesor i shkollës së mesme me tha, që e kanë pru zëvendësim dikan prej Bibaj, tha kam informacione, që ajo është balldeska e kryetarit të komunës. Tash unë e kame marr si informatë, edhe e thash, po se sa ka Vitia profesor të gjuhës frënge, në seancën tjetër do t'i jap emrat, që ata janë pa punë, ndërsa ti e ki marr prej Komunës së Ferizajt e keni pru këtu.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Nëse thuani që bursat prej 300 euro janë ndihmë sociale, nuk besoj që na qojnë kerkun. Sa do të jetë zhagjitja brenda vitit akademik, ata kanë me i marr mjetet. Çështja e mësimi jo formal. Me të vërtet nëse është ashtu ti e shtjerrë aspektin ligjor ju drejtoresh gjykatës. Nuk ka nevojë në çdo seancë me të njëjtën kërkesë. Çështje tjetër që e personalizon. Po me vjen keq prej Ekremit, ku po e qet vetëm një shtëpi në planin zhvillimor komunal. Nuk është vetëm një shtëpi, ka shumë. Në mesin e atyre që është shume meritorë është edhe ajo shtëpi që i ka shërbye luftës së fundit. Shumë po përfolët, me tha një qytetar në rrugë. Çkas mundet me të than dikush në rrugë, po nuk do me thanë që janë qashtu qyshe të thojnë ata qytetarë.

Kryetari z.Sokol Haliti: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ne si ekzekutiv po mundohem me ju përgjigj kërkesave të qytetarëve, ato kërkesa që janë legjitime dhe të arsyeshme. Ne jemi plotësisht transparent dhe kemi me qenë transparent. U flit për balldesken time. Unë e kam një balldesk, e cila punon në Prishtinë, është stomatologe. Në Komunën e Vitisë mund të ketë me gjuhe frënge, po një gjë e di, që ne konkurs nuk ka konkurre asnjë nga Komuna e Vitisë, për këtë jav argumentoj nëse doni në këtë seancë e argumentoj këtë. U thirrte në vota, mos harroni se edhe unë kam shumë me shumë se ju vota të qytetarëve. Te çështja e punëve jociësore, plotësisht jam dakort me juve. Edhe ne jemi duke u angazhuar për punë cilësore, edhe unë nuk lëshoj pe për rrugë jo cilësore dhe mos me ja pagu nëse nuk e kryen punën cilësore e me plan këtë punë jam tu e bë çdo ditë me ingjiniera, ka një ditë i hupmi tri, katër deri pesë orë. Te çështja e bursave, jam për me i përkrah rininë dhe studentët. Është çështje procedurale dhe kanjeher çështje financiare. Mirë, nëse është pak vonesë, ata ato pare kanë me i marr dhe kanë mi marr sipas kriterëve të konkursit dhe vlerësimit të komisionit. A është pak kjo ndihmë për studentët, është pak. A nevojitet me rrit këtë shumë, po nevojitet. A mundemi ta shohim buxhetin, unë e kam bë një memorandum me Ambasadën Amerikane për trajnimin e mësimdhënësve dhe nxënësve që kanë mundësi me u specializu dhe me magjistru edhe në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Shumë frikë do të jetë një ekip e profesorëve ne Amerikë. Ne i kemi benificu ekspert që kanë doktorua ne Zhenevë nga Tresteniku, kemi edhe të tjerë. Unë në mbledhjen e fundit me Bordin e Drejtorëve i kame propozu 8 rregullore. Njëra prej tyre ka qenë kjo që e propozoj edhe këshilltari Taulanti, edhe e mirëprita, rregullorja për çështjen e orarit të punës së bizneseve.

znj.Mirlinda Sadiku: Kryetari u thirr në votën e qytetarit, edhe unë e respektoj votën e qytetarit, po edhe ne jemi me vota të qytetarëve. Sa për planin dinamik dhe punët që janë duke u kry, po shihet e kemi dokumentuar shumë herë se çfarë pune të dobëta po kryhen në teren.

z.Ekrem Abazi: Kryetari tha që humb tri katër ore me ingjinjera, me bashkëpunëtorët e mijë. Ata nuk janë bashkëpunëtor e tu, po ata njerëz disa që i ki afër teje, janë duke të ra thik mas shpine, po nuk je ka i sheh se ti je tu e përdor sinqeritetin tanë po ata po të keqpërdorin, ata po bëjnë përfitime për veti, se ti kur të bisedosh me ata e dinë qe ata thojnë po po, ama po ta përsëriti, janë duke të ra thikë mas shpine, i ki hasmit më të mëdhaj. Ky është mendimi im, po edhe i shumë qytetarëve që bisedoj me ta. Kjo shihen me punët e këqija që i bëjnë, asnjë pune pa përfitua diçka nuk e bëjnë ata ingjinierat e tu. Sa i përket punësimit, kemi edhe raste të tjera që ka ardh nga komuna

tjetër, nuk konkurroj qytetaret se hala pa u shpall konkursi njerëzit vetëm caktohet në shume vende. Na e dimë para dy muajve se kush ka me ardh në atë vend të punës. Po bëjnë apel nga qeveria mos ikni prej Kosovës, unë dy djem i kam sot, me mujt i qes prej Kosovës. Kjo Kosovë ish kanë vetëm për hajna, nuk ish kanë për njerëz të rëndomtë, për njerëz që kanë nevojë për një euro, i punësojnë krejt ata që i kanë të punësuar.

z.Taulant Haxhiu: Kryetar, ti i përmende votat, ti ki garu me tre persona, ndërsa në asamblist kemi pas garë mbi 200 veta. Sa i përket votave, i di që ki pas vota, po se paku edhe unë jam me i votuari asamblist nga opozita, edhe për at jam opozitar i zëshëm. Unë dashta ta di një informatë nga ti. Vajza e kirurgut Skender Shabani a ka lidhje familjare me bashkëshorten tuaj.

Kryetari z.Sokol Haliti: Unë e luta, kuvendi nëse doni me e verifiku është fjala kush ka konkurrue të Vitisë, nuk është fjala a ka apo nuk ka. Mundet me pas, ama a ka konkurs për punë, unë jam i sigurt 100% që nuk ka konkurs, asnjë nga Vitia për profesor të gjuhen frënge. U fol për ingjinerat nuk janë ata ingjiniera të mirë, po janë institucional, ne po angazhohemi për institucione të pavarura. E drejtë e Kuvendit është, sa herë që do me pa planifikimet për çdo çështje që ju intereson. A është niveli global i ikjes së të rive edhe unë pajtohem që është mungesa e punësimit. Mungesa e gjenerimit të punësimi është nivel qendror. Unë jam garantues i zbatimit të ligjit, ata që mendoj që ju behet shkelje unë i inkurajoj që me bë ankesë me shku të organet përgjegjëse. Nëse ne e marri vendimin që po bëjmë shkelje, ne detyrohem që me marr masa, ndërsa pavarësinë e organeve dhe mbrojtjen e ligjit duhet me garantu ne.

z.Ali Bajrami: Dola që vetëm një plotësim me e bë. Sa i përket asfaltimit të rrugës, Abetarja ka qenë pakënaqësi e banorëve të asaj pjese, po për fat të mirë kemi qenë edhe një delegacion komunal, si Qahil Sinani, Ajet Sallahu, Isak Sadiku në vend të ngjarjes. Pas pakënaqësive që i kanë shpreh qytetarët dhe vlerësimi dhe biseda që i kemi bë edhe ne ishmi që ajo rrugë të mos asfaltohet, atë ditë të përmirësohet, të sanohet defektet që janë dhe pas përfundimit dhe cilësisë që do ta verifikojnë organet përgjegjës që e mbikëqyrin të behet asfaltimi i asaj rruge.

z.Sejdi Emini: Unë nuk e thash që i ki fajet ti Ali, edhe tama puna mos me pas qenë në anën e qytetarëve qat ditë, ti e unë e kushdo çoftë, a me pas lan me qit asfaltin përmi lloq aty apo jo, more qytetarët e kanë blloku rrugën atë ditë edhe shumë mirë që e kemi përkrah na.

Kryesuesi z.Naim Pira: Faleminderit të gjithëve për kontributin që dhatë, dhe pasi që Bekimi na u bashkëngjit, i uroj rizgjedhjen kryetar të partisë së ti, i dëshiroj punë të mbarë dhe suksese. Për këtë seancë kemi parapa këtë rend dite.

R e n d d i t e

1. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019.
2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 70.000 € për pagesën e obligimit të fshatrave Goshicë dhe Gërmovë për projektin e ujësjellësit.
3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Azem Bislimi (Rrustem).
4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim pronën e paluajtshme e Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër për ndërtimin e Shtëpisë së pleqëve në zonën kadastrale në Letnicë.
5. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019.
6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve ne vendimmarrje për vitin 2019.
7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit për komunitete për vitin 2019.
8. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për shkarkimin e Gazmend Hasani nga detyra e anëtarit të komitetit për persona me aftësi të kufizuara.

9. Informatë rreth ndërtimit të shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozheran.

A ka dikush rreth rendit të ditës, pasi që nuk ka e qes ne votim me ngritje dore konstatoj që me votat e të gjithëve u miratu rendit i ditës. Me kërkesën e asamblistëve pika e nëntë e rendit të ditës del për diskutim pike e parë e rendit të ditës. Kush është për këtë propozim të asamblistëve. Me votat e të gjithëve u miratu që pika nëntë e rendit të ditës të diskutohet në fillim

Pika e parë e rendit të ditës:

1. Informatë rreth ndërtimit të shkollës fillore “Halil Alidema” në Pozharan

Kryetari z.Sokol Haliti: Çështja e informatës që e keni kerku me të drejt, pavarësisht që ti besoj që je i njoftuar, ne kemi qenë pjese e takimeve, pjese e bashkëpunimit, pjesë e fillimit të procedurave të shkollës së re “Halil Alidema” në Pozharan prej fillimit. Planin dinamik të zhvillimeve të punimeve e ka deri fundvit. Në takimin e fundit që patëm me zv.ministrin që ka qenë te shkolla, ka qenë edhe kryesuesi. Unë i kam lut dhe komani që me e përfundu me 1 shtator me hi në shkollë. Kam qenë decitiv në atë kuptim, po ata që kanë qenë prezent e dinë që kam qenë shumë i prem, që me 1 Shtator, edhe pse nuk kemi të drejtë ligjore me ja imponu para përfundimit të planit dinamik, që është në fund të vitit. Unë kam pas dje takim edhe me ministrin e Arsimit, i kemi pas disa tema. Temën e shkollës se Drobeshit, që është buxhetu, shkollën “Kuvendi i Lezhës” që duhet mu rivitalizu, çerdhen në Qifllak që po dojmë me e ndërtu dhe disa dhe disa tema të tjera. Në mesin e temave që kame disku, ka qenë edhe për shpejtimin e planit dinamik të shkolle së Pozharanit, që me 1 Shtator ne me qenë në shkollë, për shkak kushteve që i kemi në shkollën e vjetër. Kompetent për këtë është ministria dhe dikasteret qeveritare, por ne jemi aty me i nejt gati me e përshpejtua. Do të mbajmë takime të tjera, në mënyrë që shkolla ne Pozharan sivjet të përfundoj. Të drejtë nuk kemi me ja imponu jashta planit dinamik, po do të insistojmë që me 1 shtator, kjo shkolle është në agjendë tonë prioritare, sepse ka qen sfidë, kemi me punu deri në fund që kjo të kryhet sa më shpejt.

Kryesuesi z.Naim Pira: Kjo informatë e kërkuar nga z,Rasim Terziqi ka qenë shumë me vend, se me të vërtet kushtet me të cilat punojnë ata nxënës, ata arsimtar atje, janë në kusht jashtëzakonisht të renda, mirëpo suksese janë evidente si të nxënësve, si të personelit, janë për lakmi. Me të vërtet ata nxënës dhe mësimdhënës meritojnë një objekt më të mirë, përpjekjet maksimale janë duke u bë nga Komuna, po shpresojmë shume që do ta merr formën finale nga fundi i vitit ky objekt. Fjalën ja jap Rasimit, pasi që ka qenë propozues i kësaj pike.

z.Rasim Terziqi: Përshëndetje të nderuar koleg! Unë e mora premtimin, paska qenë në takim kryetari me ministrin, mirë ministri është i partisë time po me pas ardh ai në Pozharan e kishe pa ai se çfarë kritike të madh i kisha dhënë, e vallai si të vjen ai nuk është i mirë se ardhur për mu. Me hi të historiku i premtimeve kur i kam thanë nënkryetarit në seancën e kaluar, se në Pozharan nuk po kryhen punët mirë, nënkryetari tha sa qashtu qysh po thua unë po thamë që nuk janë tu kry punët mirë. P.sh.: të kjo shkolla e Pozharanit nuk po kryhen punën profesionale, ku e jep një vlerësim një ekspert i ndërtimtarisë, që me një pllakë ndërtimore në katin e dyte është hedh armatura hiq pa u lidh, kush me dhanë përgjegjësi nesra me ndodhe një fatkeqësi, a e keni ju laboratorin e kontraktuar që e mbikëqyr, a e keni keshyr naj her ju këtë projekt, i cili është shumë i rëndësishëm për Pozharanin, i cili që 20 vjet është premtuar, PDK na ka lodh me premtime. Po supozojmë që nuk përfundon me planin dinamik deri në fundvit, a jemi të gatshëm unë me ty edhe krejt me dal e me blloku, mos me fillu mësimi në gjysmëvjetorin e dytë.

Kryesuesi z.Naim Pira: Unë jam i gatshëm, duhet me dal, po është projekt të cilin me se pari nuk e menaxhojmë na, e dyta është projekt që e mbikëqyr ministria, janë personat përgjegjës që e mbikëqyrin.

znj.Mirlinda Sadiku: Plotësisht ka të drejt për skepticizëm kolega. Kemi një provoj të hidhur. Në shkollën e mesme profesionale, si ka tri vite që jemi hy në ta dhe mundesh me pa çfarë punime të dobëta janë bë, aq me pak kur Vita është regjion sizmik, mos thaftë Zoti me na ndodhe tërmeti i 2002 qysh ka ndodh, aq më pak kur ka fëmij aty. Përgjegjësia e institucionit duhet të bjen edhe mbi komunën kur të behet pranimi teknik. Ju duhet me pas edhe me insistu me pas personit tuaj, i cili është përgjegjës. Unë isha tu hulumtu në buxhetin e Republikës së Kosovës, në vitin 2016 kjo shkolle është vlerësua me vlerën 1 milion e 220 mije euro, ndërsa nëse e sheh sot buxhetin të aprovuar të vitit 2019, na rezulton me 920 mije euro, d.m.th vlerësimi ka qenë për 2018 mu shpenzu dikun rreth 1 milion euro. Po ashtu totali i kësaj me qen 1 milion e 220 mije euro. Unë jam shumë septik, uroj që unë të jam gabim, se e di se çfarë gjendje të keq me dërgoj foto edhe prind të atyre prindërve, veç për punë jocilësore që po kryhen mos krijoni alibi si komunë, sepse qata fëmijët që kanë me shku në qat shkollë, është përgjegjësi edhe e juaj

me ndodh naj fatkeqësi natyrore, naj termet, diçka me gjete dikan, përgjegjësia me se pari bjen permi juve. Një vit e keni pas me bë pranimit teknik të shkollës së mesme profesionale, tana anët, ama bash tana anët edhe aty ku mbajmë mësim edhe të kabllot elektrike ka pikë problemi është, se kur e kam dokumentua qetu në kuvend me ka thirr në ashtuquajturat biseda informative drejtori, po unë se kam njet mu ndal se unë jam për qytetarët këtu dhe përgjegjësia duhet me qenë edhe e institucionit të juaj. Mos thuani është përgjegjësia vetëm e ministrisë, sepse edhe ato janë taksa tona, aq më pak të fëmija që aty nuk duhet me toleru bash hiq. Unë dysjoj se kanë ardhe tu e tkurr si projekt, prej 1 milion e 200 mije euro me ra 900 mije euro. Nuk e di a i plotëson kushtet edhe salla e edukimit fizik që e përmendi kryetari, uroj që unë të jem gabim.

z.Taulant Haxhiu: Kam një replikë për z.Razim Terziun. Unë jam në politik që 5-6 vjet, atëherë ka qenë kryeministër Isa Mustafa, tani PDK u kanë pjesë e qeverisë po su kanë e vendimmarrjes. Për punën e qytezës së Pozharanit, kur të bëhet Komorani se është me Drenicë, tani bëhet Pozharani, edhe ju NISMA jeni parti e vogël, na as në KQZ nuk ju kemi lan juve e ju me bë replikë me PDK.

z.Rasim Terziqi: Taulanti po thotë Isa Mustafa, po ky bile e nisi e ju e keni premtu 10 vite, na keni kënaq ju me premtime.

z.Bekim Azizi: Përshëndetje për të gjithë të pranishmit. Tu e pas parasysht që jemi me një pikë të rëndësishme, një informatë për shkollën e Pozharanit, se sa jeni serioz trego vet fakti që nuk i keni pru dy rreshta të shkruar. Kjo tregon sa jeni serioz. E dimë që është investim i qeverisë, mos të harrojmë se qeverisjen e PDK janë maru 12 shkolla në Viti, ndërsa masi ka kalu qeverisja e PDK-së, janë maru 2 shkolla. Po ja tregoj Rasimit këtë. Unë mendoj që sivjet ishalla e shtin nermloj at shkollë, se më shumë nuk e kanë ndërmend me bë me shumë. Unë e di që vetëm pranimit teknik sa zgjat, mirëpo çka duhet të bëjmë ne, ne duhet si pushtet t'i bëjmë presion vetëm që të shpejtohen punimet, mos të ndërpriten punimet, le të vazhdohet pa ndërpre dhe të punohet sa më cilësor.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Edhe ne si ekzekutiv po kërkojmë që të përfundohet para planit dinamik. Ju e dini që procedurat e prokurimit për këtë shkollë i ka udhëheq dikush tjetër jo komuna. U kërku nga ne me ja siguru lejen e ndërtimi, ne menjëherë ja kemi sigru, edhe pse ka qenë shumë problematik, kushteve urbanistike qysh kërkohet, largimi nga varrezat, nga shtyllat, po krejt i kemi bë të pamundurën që me të vërtet me ja siguru lejen si institucione komunale, që me fillu shkolla. Unë konsideroj që ata kanë ekspert, kur ne kemi në Komunën e Vitisë edhe ata kanë, i përcjellin punimet dhe besoj që edhe ata e din që kanë me hi fëmijët. Nuk muj me besu atë që e than disa këshilltar, që vetëm e kanë gjuajt armaturën, jo se kan ingjiner ata, ai nuk e lejon veten. Insistimi jonë duhet me qenë konformë planit dinamik. Krejt që muj me bë që ai me përfundu, ju e dini që ne kemi organizu shumë takime, ku së bashku kemi qenë edhe me kryesuesin që me e ngut procedurën, që me përfundu sa me shpejt.

zj.Mirlinda Sadiku: Me se paku të fëmijët kam shpreh patriotizëm për atë që me kanë kuptu drejtë, nesra me ndodhë një termet, përgjegjësinë duhet me e mbajt. Hajde këshyrne qysh kanë punu të shkolla ku punojmë ne.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, kalojmë në pikën e dytë të rendit të ditës.

Pika e dytë e rendit të ditës:

2. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019

Drejtori z.Ibrahim Rama: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ky propozim vendim ka të bëjë me bartjen e mjeteve nga të hyrat vetanake të vitit 2018 në vitin 2019. Ky proces i transformimit është në funksion të ligjeve në fuqi, Statutit të Komunës së Vitisë, Ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitave tjera që e përcaktojnë këtë bartje. Është praktik kjo, që kuvendi duhet ta miraton këtë bartje që të hinë në funksion të shpenzimit. Propozimin e keni marr me kohë, për pyetje jam në dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pikë të rendit të ditës. Pasi që nuk pat për diskutim e qes në votim për miratim. Kush është që të barten këto mjete? Konstatoj që me votat e të gjithëve u miratu ky propozim vendim.

Si pikë të tretë të rendit të ditës kemi:

3. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për ndarjen e mjeteve financiare në shumë prej 70.000 € për pagesën e obligimit të fshatrave Goshicë dhe Gërmovë për projektin e ujësjellësit.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Me këtë propozim vendim, kryetari i komunës parasheh që një sasi e mjeteve në vlerë prej 70.000 euro të ndahen per përfundimin e projekti që ka të bëjë me Ujësjellësin në fsh.Germov dhe

Goshicë, gjithnjë në funksion të plotësimit të nevojave dhe kërkesave të qytetarëve për ujë të pijshëm. Ky propozim vendim bazohet në memorandumun e bashkëpunimit, me të cilin Komuna e Vitisë e ka nënshkruar me 18.02.2009. Siç ka të bëjë me këtë projekt me implementuesin e këtij projekti, që është CDI-ja i financuar ky projekt nga Bashkimi Evropian, gjegjësisht Qeveria Zvicerane, Ministria e Zhvillimit Ekonomik dhe komuniteti, së bashku me komunën. Ju edhe ne vitet e kaluar kemi pas kësaj lloji problematike, që ka të bëjë me këto mjete. Propozimin e keni marr me kohë, për pyetje jam në dispozicioni e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës.

z.Sejdi Emimi: Sa i përket projektit të ujësjellësit në fshatin Germovë dhe Goshice, është një projekt që është po thuaj që 10 vite më herët, është një projekt që ka ngec për një kohë të gjatë dhe banorët kanë qenë bukur shume të shqetësuar dhe ka qenë nevojë emergjente, sepse është në pyetje uji i pijes. Deri me tani banoret kanë bart ujë prej fshatrave të ndryshme, e kemi cek shumë herë dhe kemi kërku që ky problem të zgjidhet. Sa i përket këtij projekti, banorët e fshatrave të cekur më lartë kanë participu me disa mjete të tyre. Për sa di unë, dhe jam i sigurt, që në Gushicë dikun janë mbledh 7000 euro. 3000 ju kanë kthy banorëve, mirëpo edhe 4000 CDI-ja i ka të banorëve të fshatit Gushicë. Nuk e di unë se çka ka mu bë tash me ato 4000 euro, norma duhet me ju kthy banorëve, po është lista e banorëve të cilët kanë dhënë para për këtë projekt. Tash duhet me ja kërku CDI-së dhe me ja kthy banorëve parat e tyre, të cilat i kanë dhënë. Tash ma edhe ligji nuk e lejon mu kanë participim qytetari me projektet e tilla siç është kanalizimi. Kisha kerku që edhe ju me marr këtë përgjegjësi, që me ja kthy banorëve parat të cilat i kanë dhënë. Përndryshe është projekt që banorët e mirëpresin, është jetik për ta.

z.Bekim Azizi: Mendoj që është prej pikave me të rëndësishme ku është çështja e ujit të pijshëm, sepse mendoj që me së paku është investu te çështja e ujit, që është një prej elementeve kryesore të jetesës dhe kërkesë gati e çdo fshati, sepse jemi keq në këtë aspekt, mirëpo unë mendoj që se bashku me këtë propozim që është bë, do të jemi pro, ajo nuk diskutohet ta kemi edhe një informatë, memorandumun që ka qenë i nënshkruar atje ta dimë ku është gjendja, sepse ne sot e votojmë, i ndajmë mjete, po nuk besoj që asnjë prej neve e dimë gjendje saktë se ku ka mëri ose ku është procesi i punës ne përfundim të projektit të ujit, dhe me këto 70.000 euro çka do të punohet. Ne ta dimë sa ka mu realizu, a do të jetë kyçja e qytetarëve apo do të jete vetëm plotësim i mjeteve për shtrirjen e rrjetit dhe prapë do të dalin edhe pengesa tjera sikur në pese fshatra të tjera që kanë mbet pa u kyq dhe ato fshatra kanë mbet për shkak se duhet ndoshta ata prapë të participojnë në kyqjen ta bëjnë në mënyrë vetanake apo me këto 70.000 euro do të vjen deri te kyqja e banorëve të Goshices. Nuk e kemi një informatë të plotë, por ne do të jemi pro këtij propozim vendimi.

znj.Mirlinda Sadiku: Mire kishte me qen me na dhënë sqarime drejtor. Sipas buxhetit që është miratu, Lëvizja Vetëvendosje, një prej arsyeve që e ka votu kundër ka qenë pikërisht që gjysmëmilionin euro po ndahen për shtrimin e asfaltit rrugët rurale, ndërsa vetëm 280 mije euro po ndahen për kanalizime dhe ujësjellës, kur e dimë që shumë kanalizime, siç e ceku kolegu Ekremi, në Viti mos me pas kanalizim, kjo është tmerr. Masanej e kemi ujësjellësin jofunksional ne Zhiti, Beguncë, Skifteraj, Remnik, Budrik. Prandaj me intereson ta di, qeto 70.000 euro keni mi marr prej qeti kodi. Po mendoj që i kemi nda 280 euro dhe a e keni ndërmend me bë një zgjidhje edhe për fshatin Skifteraj, Budrikë, Remnik. Sot mos me pas ujë, kur e dimë që uji është jetik. Me sa kam pas informacione, dhe sa kemi bisedu me drejtorin e “Hidro Moravës”, na ka thanë që nevojiten dikun rreth 100 mijë euro investim në fabrikën e ujit për përpunim të ujit, për arsye se kapaciteti i saj është i ultë. A është mendu në këtë drejtim, sepse po të ishte rrit kapaciteti i ujit do të ishte e mundshme që është fshati Skifteraj të rikyqet dhe do të kishte ujë edhe për fshatrat tjera. D.m.th po vërtetohet ajo pse ne e kemi votu kundër. Është shumë e rëndësishëm mu potencu, se qatë gjysmë milion euro që e keni nda për rrugë rurale, po shihet që nuk kanë shku në destinacion të caktuar. Uji është jetë. Këto lokalitete mos me pas ujë sot, edhe pse që dhjetë vite ka mbet pezull, qysh në vitin 2007/8 me Komisioni Evropian kur është investu, plus fshati Skifteraj ka mbet për shkak se e ka një borxh të rrymës elektrike, asnjëherë nuk i jepet zgjidhje këtij problemi, e mirë është që keni fillu me Gushicen dhe Germovën. Është e nevojshme, mirëpo ne vazhden e zgjedhjeve të problemit nuk po i përkrahni edhe me vija buxhetore, përdërisa nuk ka buxhet, nuk me bënë me mendu që ka me pas zgjidhje afatgjate. Është mirë edhe plotësisht pajtohem me ata dhe Lëvizja Vetëvendosje, do ta votone pro këtij propozim vendimi, por është një memorandum që ka ndodh qysh në

vitin 2009. Nuk e kemi informatën e plotë, ndoshta ka me pas nevojë edhe punë ekstra, punë shtesë, ndoshta prapë ka me pas nevojë ky Kuvend me nda mjete buxhetore. Për momentin na nuk e kemi informatën e plotë, se cila është gjendja e ujësjellësit. Nëse e ki informatë, është mirë me naj prezentu.

z.Ali Bajrami: Paraparakisht, masi vi prej ati lokaliteti, në emër të banorëve të Gushices po edhe të Germoves, do të ju falënderoj si këshilltar komunal, do të falënderoj edhe kryetarin e komunës me gjithë akteret e tjerë që kanë qenë pjese e përfundimi të këtij propozim vendimi.

z.Basri Sylejmani: Ujësjellësi ne dy Sllatinat, Tresteniku, dy Sadovinat, këtu u kanë marr prej qeverisë së mëparshme, po as ajo nuk e ka kry, po as kjo se ka kry. Tash edhe unë nuk po e di se çka është problemi në Sadovinë, ka ardh uji prej Kaçanikut. Unë propozoj, që Sadovina mu kyç në qat ujin e Kaçanikut, nëse ka mundësi. Janë kyç vetëm disa shpi, me bisedu kryetari me ata të Kaçanikut me mujt me u lidh të gjithë në Sadovinë. Edhe Potgorci është pa ujë edhe aty është mirë me bë zgjedhje.

z.Ekrem Abazi: Mjetet financiare prej 70.000euro kanë qenë obligim i qytetarëve në dy fshatrat, po mirë që po ka mundësi me i pagu komuna, sepse këta janë qytetar të Komunës së Vitisë, por ne Drobesh e ka pas marr obligim komuna me e pagu. Çdo shtëpi është ngarku me 58 euro për kyçje, pse nuk i ka dhënë komuna, mos e bëni këtë veprim apët. Uji po thojnë me shku edhe në Goshicë dhe Germovë, po ju tham që unë në shpi tem shpeshherë në katin e parë nuk kemi ujë. Prej Letnices, pjesa poshtë e Vitisë nuk ka ujë, gati gjatë tërë verës, e Sejd apet keni me mush ujë me shishe. Nëse nuk rritet kapaciteti në Letnicë, po po flitet që tash gjatë kyçës, dy fshatra të komunës tjetër, të Komunës së Kllokotit, Verbovci dhe Gerqari, kanë mu kyç, duhet me pas kujdes, është e domosdoshëm që fsh Skifteraj dhe Remnik me pas ujë. Po nëse këto dy fshatra kyçen me qef ose me zor, propozoj që gjithsesi mu kyç edhe Skifteraj dhe Remniki. Duhet me qenë një vendim i Kuvendit, që mos mu kyç fshatrat e komunave të tjera.

Nënkryetari z.Hasan Alia: Të gjitha ato që i ngritin këshilltarët në aspekt të ujit, është e nevojshme. Kerkush nuk e demanton këtë, megjithatë këtu po bisedojmë për një propozim vendim, me i benificu dy lokalitete për shkak të projekti që u lënë në gjysmë. Ky obligim nuk është i komunës, ky obligim ka qenë i qytetarëve të Germoves dhe Gushices. Nuk u kry obligimi, ne projektin sun e lëmë ne gjysmë, Sejda tha 4000 euro. Unë në atë kohë nuk kam qenë në pushtet, nuk e di kush i ka marr ato, atë çështje duhet me e ngrit ju këshilli i fshatit në raport me CDI-në, jo komuna. Komuna në marrëveshjen e nënshkruar, që thotë 70.000 euro, ka mbet lokaliteti borxh me zgjedh këtë punë. Ne po i propozojmë kuvendit me hec përpara, se uji është i domosdoshëm. Jam duke insistu që sa me shpejt mu leshu ndërrimin e gypit që është bë, kam pas takime, ju kam dhënë afat deri me 15 Prill, për çdo ditë i kontaktoj në tel, ju kërkoj që mu bë kjo me këtë datë që e kam dhanë dhe është e nevojshme. Jane duke punuar intenzivisht dhe ta shohim se sa jemi ne gjendje me e furnizu vendet që janë të lidhur këtu. Kam informacione shumë të sakta, se prurjet që vinë në fabrikën e Letnices, nuk është ne gjendje fabrika me i perpunu, kapaciteti i saj është më i ultë, sa do të kushton rrija e kapacitetit për përpunimin e ujërave. Nuk e dimi na, janë ekspertët që e vlerësojnë, është një projekt bukur i madh, po ne duhet ta shqyrtojmë këtë në buxhetin që vjen këtë vit. Unë jam i interesuar që qytetarët e Vitisë me pas ujë të gjithë, kyçjen në çdo lokalitet i bën individi, donë me pas ujë, kyçet. Në mandatin e kaluar, unë kam qenë në Kaçanik, takim me kryetarin dhe nënkryetarin, për Remnikin e Ri dhe shume burrërish ma kanë kry punën. Kanë thanë po janë afër, mundet mu kyç në gypin e ujit të Kaçanikut dhe ata janë kyç me Kaçanikun. A kanë marr edhe shpitë tjera, edhe nëse e kanë marr e kanë marr ilegalisht.

Drejtori z.Ibrahim Rama: Ne e dimë që Komuna e Vitisë ka deficit në furnizimin e qytetarëve me ujë. Përpjekjet dhe marrëveshjet shtetërore kanë qenë në funksion të bashkëpunimit më faktorin ndërkombëtar, përmes donacioneve të ndryshme të finalizohen dhe të furnizohen qytetarët e Komunës së Vitisë me ujë të pijshëm dhe në këtë drejtim proces hala janë deri në vitin e kaluar. Janë në favor të bashkëpunimi të Ministrisë Zvicerane implementuesi CDI-ja dhe “Hidro Morava” përmes Ministrisë së Zhvillimit Ekonomik. Gjitha këto projekte janë kryer në bashkëpunim, kurse prej viti 2018 e këndej Qeveria Zvicerane japë donacione veç kompanisë regjionale “Hidro Morava”, kurse komunat ma nuk munden me qenë përfutuese të donacioneve të ndryshme që kanë të bëjnë me sistemin e ujësjellësit. Në këtë drejtim edhe ne një projekt që ka qenë kornizat e këtij ligji, që ka qenë bë bashkëpunim me Qeverinë Zvicerane, është edhe kjo marrëveshje e nënshkruar nga Internacional Llogos, në at

kohe Selvia Sher Hanë, Asil Vokshi implementues nga CDI, Nexhmedin Arifi kryetar i Komunës së Vitisë, Flamur Zeqiri Drejtor Ekzekutiv i “Hidro Moravës”, Musa Emini përfaqësues i fshatit Goshicë dhe Xhemajl Sylejmani përfaqësues i fshatit Germovë. Të gjitha janë akter të nënshkrimit të kësaj marrëveshje, e cila është ende e papërfunduar dhe e plotfuqishme ligjërishit dhe ne gjatë propozim vendimin që e kemi sjell para juve, jemi bazu në këtë marrëveshje dhe në ligjet e tjera pozitive që janë në fuqi. Ke një pyetje për 4000 euro që kane participu qytetarët. Unë e kam thanë edhe me përfaqësuesit që kanë me e implementu këtë projekt, këto mjete ne do ti definojmë nëse saktësisht vërtetohet se ku janë. Ne do ti zbresim nga shuma që do ti paguajmë implementuesit, do ta analizojmë komplet lenden. Sa i përket burimit të ujit, konsiderojmë që burim të ujit ka Vitia, jemi tu planifiku me investu ne rrjedhën e furnizimit me ujë dhe ne kapacitetet e ujit. Unë besoj që me një të ardhme të afër, ka me pas sasi të mjaftuar të ujit Goshica, Smira, Verbani e Smira se edhe këto projekte janë në fazën e përfundimit, dhe se bashku me juve do të angazhomi që vitin e ardhshëm me e projektu edhe rritjen e sasisë së ujit dhe përpunimit të tij. Pyetje tjetër ishte, se çka nënkupton me këtë investim prej 70.000 euro, përveç kyçes si sistem do të jete funksional 100%, kyçja është një projekt në veti. D.m.th që nuk definohet me këtë marrëveshje sikur kyçjet tjera që janë bë ne fshatra tjera. Është një projekt që duhet me e ekzekutu “Hidro Morava” në bashkëpunim me kërkesat apo vullnetin pozitiv të qytetarëve, përndryshe projekti duhet me qenë i përfunduar teknikisht për shfrytëzim. Pjesa tjetër i lihet qytetarëve dhe “Hidro Moravës”. Përgjegjësinë për kyçje e merr “Hidro Morava”.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, e qes në votim. Kush është që të kalon kjo pikë? Konstatoj që me votat e përgjithshme u miratu edhe kjo pikë e rendi të dite.

Si pikë të katërt të rendit të ditës kemi:

4. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për këmbimin e pronës se paluajtshme komunale me pronën e paluajtshme në pronësi të pronarit Azem Bislimi (Rrustem)

Drejtoresha z.Majlinda Ostroglava: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Materialin e keni të gjithë. Kjo pikë ka qenë njëherë në rend dite, po për shkak që ligji nuk na lejon që direkt me shku për këmbim, propozimi parapak ka qenë zonë me interes, tash është këmbim nëse keni pyetje shtesë, jam ne dispozicionin e juaj.

Kryesuesi z.Naim Pira: A ka dikush për me diskutu? Pasi që nuk ka, e qes në votim. Kush është që të kalon kjo pike? Konstatoj që me votat e përgjithshme u miratu edhe kjo pike e rendi të dite.

Pika të pesë të rendit të ditës kemi:

5. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për dhënien ne shfrytëzim pronën e paluajtshme e Komunës së Vitisë në shfrytëzim afatshkurtër për ndërtimin e Shtëpisë së pleqëve në zonën kadastrale në Letnicë

Drejtoresha z.Majlinda Ostroglava: Me këtë propozim paraprak, propozohet që ti jepet ne shfrytëzim prona e paluajtshme e Komunës se Vitisë, ne shfrytëzim afat shkurt për ndërtimin e shtëpisë se pleqve në zonën kadastrale të Letnice, Me këtë propozim vendim, prona e paluajtshme komunale që propozohet të jepet në shfrytëzim, ka këto karakteristika: Parcela me nr. P -70101027-00032-2 , në vendin e quajtur „Laf Deja“ , shfrytëzimi aktual toka pyjore me sipërfaqe prej 20000 m², në zonën kadastrale në Letnicë, Afati kohorë për dhënien në shfrytëzim të pronës së paluajtshme të Komunës, të cekuar në nenin 2 të këtij propozim vendimi është 15 (pesëmbëdhjetë) vjet, me mundësi vazhdimi, caktimi i afatit kohorë për ndertimin e shtëpisë së pleqve duhet të jetë: brenda një viti duhet të filloj projekti dhe brenda tri viteve të përfundoj, në rast të mos realizimi të projekti prona i kthehet komunës. Nese keni pyetje shtese urdheroni.

Kryesuesi z.Naim Pira: Hapi debat për këtë pike të rendit të ditës:

z.Samet Idrizi: Përshëndetje të nderuar të pranishëm! Ky propozim vendim vet formulimi të jep mundësi edhe me kërkua sqarim dhe me dhënë sugjerim. Isha lidh menjëherë tek neni 3, afati kohor për dhënien në shfrytëzim të pronës se paluajtshme të komunës se cekur ne neni 2 të këtij propozim vendimi 15 vite po mo me doket pak një mendimi me bë një ndertesë për shtëpi të pleqve dhe me sopozi për një kohe afatshkurt, po me doket pak jo mirë e mendume, jo e qellume. Caktimi i afatit kohor për ndërtimin e shtëpisë duhet të jete brenda 1 viti, duhet të filloj

projekti dhe brenda 3 vite të përfundon, në rast të mosrealizimit të projektit, prona i kthehet komunës, tu e pas parasysh, se kemi të bëjmë me një hapësirë dy hektar dhe me një vend me duket që është zona e pyllëzume, duhet të jemi shumë të vëmendshëm kujt nesra muj me ja dhënë këtë, sepse ai mundet me hy aty me e demtu terrenin edhe fund mu terjek ose krejt në fund me provu me ja ndërru destinacionin, kështu që kur të fillojmë, nëse fillojmë, dhe ja japim dikujt këtë vende kur ti bëjmë kushtet e marrëveshjes të parashihet penalizim për palën që nesër mundet me marr me u penalizu në rast që ai e dëmton ambientin aty. E kame edhe një pyetje, se kush e ka inicju këtë dhe kush mundet me qenë investitor potencial në të ardhmen?

z.Nijazi Isaku: Edhe unë pajtohem me Smetin, që fillimisht për çështjen e distinitimit, ndoshta duhet me pas një nen të veçantë në momentin që ndërrohet distinitimi i projektit me lan me vendim automatikisht që ajo prone me ju kthy komunës. Nëse votohet kjo, tash komisioni e vlerëson ofertuesin me të suksesshëm, atëherë qaja ofertë i vjen kuvendit, e miraton kuvendi, tani e nënshkruan kryetari. Kjo ka qenë e gjetur e auditorin vitin e kaluar.

z.Basri Sylejmani: Edhe unë pëlqej me koleget e mij parafolës, kjo është punë e mirë, nëse ndërtohet mirë, po nëse donatori brenda një viti nuk fillon me ndertu, ti merret leja.

z.Ali Bajrami: Nuk guxojmë të paragjykojmë që të ju ndërrohet distinitimi, ku në propozim vendim është cekur mire dhe i specifikuar, e dimë qëllimin pse po e votojmë dhe është propozim vendim shumë i qëlluar.

z.Samet Idrizi: Unë nuk pata asnjë paragjykim, po çështja është se perime formulimi të neni i 3, unë nuk e kisha formulë kështu hiq, duheshe mu kanë shumë i sigurt nëse lëshohesh me një projekt kaq madhor, edhe këtu e shkruan brenda një viti duhet të fillon dhe brenda tri vite të përfundoj. Në rast se nuk kryhet, qysh ti parasheh tani me ju kthy prona komunës. Nëse krejt ai dështon, dëmtohet ambienti, munden mu pre dy hektar drunj aty edhe ne fund çka normal që duhet mu specifiku nëse ai nuk e kryen punën duhet mu gjobit. Ne i dimë pronat në Kosovë që kanë investu dhe masi kanë fillu e kane ndërru destinacionin.

z.Jakup Demiri: Te ky propozim vendim, këtu po thotë mënyra dhe kushtet e shfrytëzimit të pronës së paluajtshme, do të përcaktohen me kontratë e cila do të lidhet dhe nënshkruhet në mese të kryetarit të komunës dhe investitorit. Ne si asamblistë, qet mënyrën e shfrytëzimit nuk e kemi të kjart ne sot që votojmë për mënyrën dhe kushtet e shfrytëzimit nuk votojmë.

z.Nijazi Isaku: Ideja pse duhet me qen distinitimi eshte se ne momentin që e ndërrohet dhe kur bën dispozit e parashe edhe pasojat nëse e sheh qet dispozit edhe ai investo e ka parasysh vendimin e kuvendit komunal po pajtohem që duhet me qen edhe masa gjobitese.

z.Ekrem Abazi: Ne e dimë që ka ligje dhe ekzistoj, po sa po zbatohen na me than para 8 ose 10 vite ja kemi dhënë një prone një personi. Kurrë as nuk ka punu, as nuk ka bë asgjë, ne ja kemi dhënë atë pronë, kurrë asnjë kamjan zall nuk e ka qit aty. Plotësisht pajtoj me parafolësit që folën, që duhet distinitim me qenë vetëm shtëpia e pleqëve, të afati kohor që me fillu për një vit plotësisht pajtoj, po të ndërtimi e kisha lan afat kohor bile pese vite a për me fillu me pas një vit.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Konsideroj që është një propozim vendim i kompletimit, se vete titulli thotë: “distinitim për shtëpinë e pleqëve”, dhe nuk kemi çka bëjmë pazarllak ne këtu. Të gjithë ata që konkurrojnë me elaborate të tjera, binë se thirrja jote është shtëpi e pleqëve, tu e pas parasysh, atë që e ngriti Ekremi. Edhe unë kam qenë ai që kam votu pro ati, mirëpo tash nuk do të lejoj ma që mos me ja caktu afatin e fillimit, edhe at që e shtroj Sameti. Konsideroj që në marrëveshje e cila behet, duhet të pasoj ajo marrëveshja, me konkretisht ku një prej neneve të marrëveshjes mu cek në rast që behet dëmtimi i kësaj, do ta kompensoj në shume sa e caktoj ekspertet e asaj mase. Iniciativa është e një qytetari, po nuk do të thotë se ka me marr ai, por sikur mos me qenë një kërkesë e dikujt, ndoshta edhe institucionet komunale kishin fjet dhe si kishe shku mendja. Ne kemi bë thirrje, e ai i cili garanton që ka me e ndertu, e komisioni i vlerëson ofertat më të mira, distinitim kryesor e ka shtëpinë e pleqëve, ndërsa objekte tjera përcjellëse, ka me pas si trafën e rrymës, po qëllimi kryesor është ndërtimi i shtëpisë se pleqëve.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë për diskutim, unë e qes në votim. Kush është që te miratohet ky propozim vendim? Nga të gjithë u miratu kjo pikë e rendit të ditës.

Si pikë të gjashte, shtat, tetë, nëntë të rendit të ditës kemi:

- 6. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për persona me aftësi të kufizuar për vitin 2019.**
- 7. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit konsultativ për pjesëmarrjen e qytetarëve ne vendimmarrje për vitin 2019.**

8. Propozim vendim për shqyrtimin dhe miratimin e planit të punës të komitetit për komunitete për vitin 2019.

Pasi që janë plane të punës, me miratimi e juaj a mundemi që ti votojmë krejt se bashku ne paket. Nga të gjithë u miratuan që këto pika të miratohen në pako. Tani hapi debat për këto pika.

z.Ekrem Abazi: Unë po pyesë, se a do të ju krijohet kushte këtyre anëtarëve të Komitetit për Persona me Aftësi të Kufizuar, që ta realizojnë planin e punës, sepse duhet me ju siguru kushte që të zbatohet ky plan. Edhe në KPF kam pyet, a ka të punësuar ndonjë person me aftësi të kufizuar, përgjigjen që kam marr ka qenë një i punësuar në Pozharan. Ose a keni punësuar ndonjë anëtar të familjes së personave me aftësi të kufizuar.

znj.Mirlinda Sadiku: Ne e kemi një strategji, ka pas kosto financiare, kurrë nuk është implementu, ka mbet në sektor të komunës. Nëse e këshyrë si popullsi në përqindje, këto janë informata që mi ka dhënë z.Remzi Musliu, 500 persona janë me aftësi të kufizuara në Komunën e Vitisë, që ne përqindje të popullësisë i bien 7.5%. Vet fakti që nuk është përcaktu buxhet edhe nuk ndahet buxhet, shihet kjo se sa përkrahet kjo kategori e njerëzve. Në bisedën që e kisha mbrëm, më të tha që zyra jone rrinë e mbyllur për 8000 euro, brenda vitit nuk kemi mundësi me qëndru në zyre, sepse nuk kemi mundësi me e pagu rrymën, edhe këta janë qytetarë të Komunës së Vitisë. Në plan po e shoh që e kanë cek ekskursion personat me aftësi të kufizuara, sa i keni përkrah me jav pagu një ekskursion, një autobus 150 euro me pas qasje, p.sh.: sipas ligjit çdo i 50 duhet të punësohet një person me aftësi të kufizuar. Sa u zbatu kjo, kemi nderime, kemi institucione që ndërtohen të cilat nuk i kanë pjerrinat, nuk i parashohin pjerrinat. Rasisht një ditë përdërisa isha tu shku në Ferizaj, e pash një person në karrocë, dhe kogjo mundet pati mu ngjit deri në trotuar, janë shumë elemente që janë parapa. Në strategji ka pas kosto financiare, pikërisht ne VV e kemi ngrit çështjen dhe një prej pikave që e kemi kundërshtu, është se ky institucion nuk është përkrah. Sipas fjalëve të Remzi Musliut, Komuna e Vitisë është e vetmja komunë që nuk i përkrah. Për me ja argumentu këtë, është se muajnë e kaluar, kuvendit komunal i Podujevës, me 15 mije euro ka bë propozim vendim edhe ka përkrah shoqatën e cila merret me këtë kategori të personave. Këta njerëz janë të mbyllur në shtëpi dhe nuk kanë përkujdesje institucionale. Po sipas Remzisë, pa pasur premtime të shumta nga kryetari, prandaj një plan i punës nuk ka kosto financiare. Këta njerëz leje që janë të dënuar me aftësi të kufizuar, por nuk janë edhe të përkrahur nga institucionet. Ne shumë shpejt besoj që do ta bëjmë një propozim vendim. A do të miratohet, vlen të shihet, mirëpo ja vlen, se edhe këta janë pjesë e kësaj shoqërie.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Po ju lutem, që kategorinë e njerëzve për të cilën po flasim ,mos të debatojmë, pse unë konsideroj që vete debati dhe thirrja u kane në programin tim në mesin e 15 pikave, i lëndon ata persona, ju jeni ata të cilët e keni aprovu buxhetin, mirëpo nuk janë të papërkrahur. A janë përkrah sa kanë nevojë ata, po thamë jo, jo vetëm ata, po asnjë kategori shoqërore momentalisht ne Kosove nuk janë të përkrahur. Po unë po ju thamë që i kemi ndihmu edhe OFA-KOS, HENDIKOS, shoqatën e të burgosurve politik, me sa kemi mundësi ju kemi ndihmu. Edhe në komunë kanë qasje, ju kemi kriju pjerrinat, i kemi prish trotuarin, nuk mundesh me thanë që nuk kemi bë asgjë. A kanë nevojë hala me bë për ta, po ka nevojë. Unë e falënderoj për këtë plan që e ka bë.

znj. Mirlinda Sadiku: Unë këtu nuk po shoh kosoto hiç, e ki strategji që e kemi votu në legjislaturën e kaluar. Qeta persona me i qu ne ekskursion hiq nuk ka kosto, momentin që nuk ka kosoto nuk ka pare, ku kanë mu marr ato pare 2500 euro mos ja paguani mësuesve një drekë për 7 Mars. Ka mundësi, përkrahni këta persona, ka hapësira buxhetore.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Unë nuk të thash që ke çpik. Nëse ti do me ju referu at që e thash unë, qu hajde dalim me këtë ekipe, edhe i sheh pjerrinat që e kemi bë na. Nëse do, hajde në Zyre të Kryetarit të Komunës ta gjej vendimin që ju kemi ndihmu Hendikosi dhe Ofakos, unë jam përgjegjës për atë. Sa është shuma nuk e di, ama me ju ndihmu ju kemi ndihmu.

z.Jakup Demiri: Pikërisht që është kategori e ndjeshme, është mirë na t'i bëjmë planet dhe projektet me kosto financiare dhe mos me lan kërkan me manipulu me atë kategori, po që nuk është bë sa duhet, nuk është bë sa duhet për këtë kategori. Ne i kemi pas ne KPF-në 22 propozime, po drejtori i Financave nuk i ka marr për bazë hiq ato propozime.

Nënkryetari z.Hasan Aliu: Tash e kemi një thirrje të gjithë ata që kanë nevojë, që veprojnë si OJQ, duhet me konkurre dhe e paraqet planin brenda një viti sa i kushton dhe vendoset komisioni, ja ndan mjetet.

Kryesuesi z.Naim Pira: Pasi që nuk ka të tjerë, unë e qes në votim se bashku pikat e cekura me lartë. Nga të gjithë të pranishmit u miratuan këto pika të rendit të ditës.

Si pikë të fundit e kemi:

9. Propozim për shqyrtimin dhe miratimin e propozim vendimit për lirim të Gazmend Hasani nga detyra e anëtarit të komitetit për persona me aftësi të kufizuara

Kryesuesi z.Naim Pira: Kjo është me kërkesë të tij. Unë hapi debat. Pasi që nuk ka për debat, e qes ne votim. Nga të gjithë të pranishmi u miratu edhe kjo pikë e rendit të ditës.

Mbledhja përfundoi me punë në ora 14:20 min.

Procesmbajtësi:
Fatlum Demiri

Kryesuesi i Kuvendit Komunal:
Naim Pira
